



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 22.06.2023

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 21.06.2023.

Znj. _____

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 21.06.2023 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1- Sa është numri i shkollave në Bashkinë tuaj?

-Në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë janë 13 shkolla në funksion.

2- Sa ka qënë numri i nxënësve në 9-vjeccare në vitin shkollor 2021-2022 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për klasën e parë?

- Numri i nxënësve të regjistruar në shkollat 9-vjeçare për vitin 2021-2022 ka qënë 550 nxënës

-Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë për vitin 2021-2022 ka qënë 47.

3- Sa ka qënë numri i nxënësve në 9-vjecare në vitin shkollor 2022-2023 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për klasën e parë?

-Numri i nxënësve të regjistruar në shkollat 9-vjeçare përvitin 2022-2023 ka qënë 421 nxënës.

-Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë për vitin 2022-2023 ka qënë 34.

4- Sa ka qënë numri i nxënësve në gjimnaz në vitin shkollor 2021-2022 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për vitin e parë?

-Numri i nxënësve në gjimnazet e territorit të Bashkisë Himarë për vitin 2021-2022 ka qënë 149 nxënës.

-Numri i nxënësve të regjistruar në vitin e parë në këto gjimnaze për vitin 2021-2022 ka qënë 40.

5- Sa ka qënë numri i nxënësve në gjimnaz në vitin shkollor 2022-2023 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për vitin e parë?

- Numri i nxënësve në gjimnazet e territorit të Bashkisë Himarë për vitin 2022-2023 ka qënë 130 nxënës.

-Numri i nxënësve të regjistruar në vitin e parë gjimnaz për vitin 2022-2023 ka qënë 44.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!